

KRYEARTIKULL

Bashkë ndërtojmë të ardhmen e komunitetit

Projekti WISE Përfshirja rinore në komunitet ndihmon në integrimin e vendit. **VIJON NE FAGEN 8**



EDITORIAL

Reforma që modernizon shërbimet lokale

Nga Romina Kuko
Zëvendësministër
i Brendshëm



Reforma Administrative Territoriale është shembulli i qartë i vizionit të Qeverisë për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore, si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik në nivel lokal. Një proces decentralizimi sipas standardeve evropiane, me qëllim rritjen e shërbimeve për qytetarin, kërkon mbështetje dhe fuqizim të njërive vendore. Paralelisht, thelbi i reformës është eliminimi i fragmentarizimit të panevojshëm, çka u shoqërua me delegimin e funksioneve të reja tek pushteti vendor. Kalimi i shërbimeve nga pushteti qendror në atë vendor, përfshin një sërë fushash publike të rëndësishme si; arsimit, shëndetësia, kujdesi social, rendi publik dhe mbrojtja civile; mbrojtja nga mjedisi, etj. Rezultatet e kësaj reforme u ndjen menjëherë tek qytetarët. Kjo reflektohet në ofrimin e shërbimeve publike, përmirësim të qeverisjes...

VIJON NE FAGEN 3

FORUMI LOKAL

Bashkitë për turizmin dhe mbrojtjen e mjedisit

Dy histori sukcesi sesi Bashkia Korçë dhe ajo e Patosit falë përkushtimit komunitar dhe procesit të decentralizimit kanë mundur të ofrojnë shërbim cilësor në turizëm dhe kulturë të re qytetare në mbrojtjen e mjedisit.

6



ARRITJET 2018

“e-Bashkia” / Risia e bashkisë së Urës Vajgurore

ShAV së bashku me Bashkinë e Urës Vajgurore prezantuan sistemin risi të shërbimit ndaj qytetarëve, e-Bashkia. Kjo formë digjitalizimi ndihmon në dhënie të një shërbimi të saktë, transparent dhe në minimumin e kohës, duke shmangur korrupsionin dhe zvarritjet burokratike.

4

SHTYLLAT KRYESORE



AUTONOMIA
VENDORE



DECENTRALIZIMI



DEMOKRACIA
LOKALE



RRITJA E
KAPACITETEVE



EDUKIMI
DHE SPORTI



MJEDISI

Përmbajtja

KORRIK 2018 NUMRI 2



02. EDITORIAL

Adelina Farrici, Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore

03. EDITORIAL

Reforma që modernizon shërbimet lokale

04. ARRITJE 2018

- Reforma e Ujit
- e-Bashkia Risja e Urës Vajguore
- Vizitë Studimore në Malin e Zi
- Qytetet Urbane Inteligjente
- Diferencat janë ato që na bashkojnë Objektivat

06. FORUMI LOKAL

- Opinion nga Rajmonda Ballaj, Kryetare e Bashkisë Patos
- Intervistë me Benila Terova, Zëvendëskryetare e Bashkisë Korçë

08. HISTORI SUKSESI, PROJEKTI WISE

- ShAV fiton projektin WISE
- Përfshirja rinore në komunitet ndihmon integrimin



SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE

Adresa

Bulevardi Zogu I,
Godina 7-katëshe, Kati 5

Email: alisa.limaj@shav.al

Ky buletin synon të kthejë në një standard konvencional informimin e qytetarëve dhe të aktorëve të rëndësishëm në vend, rreth zhvillimeve të fundit në sferën e pushtetit vendor, e veçanërisht duke trajtuar tematika të ndryshme rreth autonomisë vendore dhe sfidave në qeverisjen lokale.

EDITORIAL NGA DREJTORESHA E SHOQATËS PËR AUTONOMI VENDORE

Zj. Adelina Farrici - Drejtoreshë Ekzekutive

Të dashur lexues,

Në emër të Shoqatës për Autonomi Vendore kam kënaqësinë t'ju drejtohem sërish përmes këtij numri të dytë të Buletinit tonë periodik. Ne synojmë ta kthejmë në një standard konvencional informimin e qytetarëve dhe të aktorëve të rëndësishëm në vend, rreth zhvillimeve më të fundit në sferën e pushtetit vendor, e veçanërisht duke trajtuar tematika të ndryshme rreth autonomisë vendore dhe sfidave në qeverisjen lokale. Përmes numrit të dytë ne dëshirojmë të njohim lexuesin mbi zhvillimet e pjesës së parë të vitit 2018, ku një prej zhvillimeve më të rëndësishme ishte ai për reformën e ujit, ku bashkitë e vendit zotohen të vijojnë zbatimin me përgjegjësi të kësaj reforme deri në fund.

Një moment tjetër është ai i risive në fushën e ofrimit të shërbimeve publike nga e-Bashkia dhe prezantimi i njësisve tona vendore me përvojat e reja botërore që kanë sjell aplikimi me sukses i politikave evropiane për qytetet inteligjente dhe energjisë efçente. Për të vazhduar me vizita studimore dhe takime me homologët tanë dhe autoritete të tjera shtetërore nga Rajoni, si dhe me pjesëmarrjen e kontributin e Shqipërisë në Konferencën e Bashkive dhe Rajoneve mbi "Përfshirjen dhe Diversitetin, dhe rolin e gruas në komunitet".

Gjithashtu, në këtë edicion do të gjeni intervista dhe opinione për ecurinë dhe sfidat e Reformës Territoriale nga



Zëvendësministrja e Brendshme, Romina Kuko, turzimi korçar dhe fushatat sensibilizuese të të rinjve në Bashkinë e Patosit. Dëshmi, projekte dhe objektivat e radhës do të zënë një hapësirë tjetër të këtij pamfleti, duke uruar që ky produkt t'i bashkëngjisë sado pak vlera informuese sektorit të bashkësisë lokale.

Duke ju falenderuar për kohën dhe konsideratën, ju urojmë lexim të këndshëm!

E juaja,
Adelina Farrici

REFORMA QË MODERNIZON SHËRBIMET LOKALE

ROMINA KUKO - ZËVENDËSMINISTËR I BRENDSHËM

VIJON NGA FQAË 1

...dhe llogaridhënies, rritje të efikasitetit të shërbimeve vendore, por edhe zhvillim ekonomik dhe social gjithëpërfshirës, për shkak të vendosjes së pushtetit vendor më pranë nevojave të komunitetit. Ministria e Brendshme (MB), e cila është edhe ministria përgjegjëse për çështjet vendore, udhëheq këtë proces duke lehtësuar të gjithë hallkat e decentralizimit dhe çështjeve vendore, e mbi të gjitha mbështetur proceset pas reformës së re territoriale. Kjo "mbikëqyrje" konsiston si në planin rregullator ashtu dhe ligjor, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative të NJQV-ve, por dhe të asistencës direkte për arritjen e standardizimit të shërbimeve. Në kuadër të përgatitjes, implementimit, monitorimit dhe rregullimit të integruar të politikave janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), ku ministria e Brendshme ka një rol kyç në funksionimin e tyre. Qëllimi është orientimi i të gjitha politikave ndërmministrorë në funksion të arritjeve të objektivave në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore, dhe të asaj Evropiane.

Në këtë aspekt, është formuar edhe Këshilli Konsultativ i Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Qendrore i cili është forumi kryesor në të cilin qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në to. Fokusi i punës së këtij Këshilli ka qenë kuadri ligjor për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve; ambalazhet e Mbetjeve të tyre; Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, etj.

Si pasojë e këtij bashkëpunimi është institucionalizuar procesi i konsultimit Qeveri Qendrore-Vendore, janë finalizuar projektvendime që prekin funksione dhe interesa të bashkive, koordinuar aktet nënligjore, rritur informacionin dhe transparencën, etj.

Bazuar në objektivat tona kryesor, afat-shkurtra dhe afatmesme, në kuadër të thellimit të demokracisë lokale dhe zhvillimit të lokaliteteve të vendit, do të vlerësojmë katër prej tyre:

Rritja e efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore;
Forcimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale;
Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor;



Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Ndërsa përsa i përket vizionit tonë afatgjatë Qeveria Shqiptare ka bindjen se përmes nisjes së kësaj reforme do të bëhet i mundur përmirësimi i mirëqeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike më eficient nga qeveritë vendore.

Një nga pikat kyçe të kësaj reforme është menaxhimi më eficient i financave vendore, ku për herë të parë njësitë vendore kanë pasur mundësinë që Programin Buxhetor Afatmesëm ta hartojnë në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, të cilat përputhen me vizionin për zhvillimin me infrastrukturë moderne e transport publik cilësor, me shërbime efikase e cilësore për qytetarin.

Së dyti, rritja e kapaciteteve të bashkive e veçanërisht në implementim e funksioneve të reja dhe në aplikimet për fonde e BE-së.

Së treti, rritja e ndërveprimit qeveri

qendrore - qeveri vendore, e cili do të forcojë më tej bashkëpunimin ndërmjet ministrive sektoriale dhe bashkive lidhur me zbatimin e funksioneve të reja të deleguara.

Së katërti, forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe menaxhimit e trajtimit të ankesave të qytetarëve do të përmirësonte ndjeshëm nevojat e tyre në ofrimin e shërbimeve publike cilësore. Së pesti, synohet zvogëlimi i pabarazisë në aksesin në shërbime në raportin urban-rural.

Së gjashti, mendohet se decentralizimi ndikon pozitivisht edhe në buxhetimin me pjesëmarrje ku mëtohet të nxitet interesi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjet për përdorimin e taksave dhe kontributeve të tyre.

Së fundmi, thelbi i reformës mbetet tek rritja e demokracisë në nivel vendor, çka jo vetëm do të përshpetojë proceset integruese por do t'i japi edhe një zhvillim transformues lokaliteteve të vendit.

Arritje 2018

AKTIVITETE DHE OBJEKTIVA

Shoqata për Autonominë Vendore ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme gjatë 6-mujorit të parë 2018.

REFORMA E UJIT

Në fillimvit, në takimin e parë vjetor të mbajtur me kryebashkiakët e vendit, fokusi u vendos tek Reforma e Ujit. ShAV kontribuoj në këtë proces përmes koordinimit të bashkive dhe ndërgjegjësimin e komunitetit rreth ligjëritimit të marrëdhënieve me ndërmarrjen e bashkisë përkatëse pa asnjë penalitet ligjor, ashtu siç kanë e po bëjnë me mijëra konsumatorë familjarë e biznese.



VIZITË STUDIMORE NË MALIN E ZI

Në muajin Mars, së bashku me pesë kryebashkiake të vendit, ShAV zhvilloi një vizitë studimore dy-ditore në Republikën e Malit të Zi. Gjatë kësaj vizite delegacioni i ShAV u prit nga një sërë autoritetesh të larta shtetërore në Parlamentin e Malit të Zi dhe institucione të tjera qendrore e lokale, siç ishte Zëvendësministri i Turizmit, Zëvendësministri i Arsimit dhe Kryebashkiaku i Komunës së Ulqinit. Gjithashtu, delegacioni i Shoqatës u takua dhe me homologët e saj në Malin e Zi, ku u prit nga Drejtuesi i Unionit të Bashkive të Malit të Zi. Objektivi i kësaj vizite i paraprindë krijimit të urave të komunikimit mes institucioneve të rëndësishme të vendit me qëllim shkëmbin e përvojave, informacionit dhe bashkëpunimin në projekte potenciale.



E-BASHKIA RISIA E URËS VAJGURE

ShAV së bashku me Bashkinë e Urës Vajgurore prezantuan sistemin risi të shërbimit ndaj qytetarëve, e-Bashkia. Kjo formë digjitalizimi ndihmon në dhënien e një shërbimi të saktë, transparent dhe në minimumin e kohës, duke shmangur korrupsionin dhe zvarritjet burokratike.



AUTONOMIA VENDORE

Përmes forcimit të autonomisë vendore synohet më shumë të drejta dhe liri për qytetarët brenda një njësie të caktuar vendore. Në këtë aspekt, më shumë mundësi për vetëqeverisje përmes strukturave dhe mekanizmave demokratik të zgjedhur prej tyre, do të thotë më shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal.



DECENTRALIZIMI

Transferimi i më shumë pushteti nga qeverisja qendrore drejt bashkive të vendit sjell një zvogëlim domethënës në kohën e marrë për vendimmarrjen, reduktimin e kostove administrative dhe plotësimin e nevojave reale të komunitetit.

DEMOKRACIA LOKALE

Gjithëpërfshirja e qytetarëve, sektorit privat dhe organizatave jo qeveritare të komunitetit në proceset vendimmarrëse lokale dhe zotërimi në duart e tyre të mekanizmave të llogaridhënies është një parakusht për një demokraci lokale funksionale.



Sferat Kryesore

QYTETET URBANE INTELIGJENTE

Ndërkohë, Shoqata për Autonominë Vendore mbështeti aktivitetin e zhvilluar nga Ambasada e Mbretërisë së Danimarkës në Kroaci - Këshilli Tregëtar Danez për Shqipërinë, me temë "Bashkitë/Qytetet Urbane Inteligjente dhe Industrinë e Energjisë Efiçente". Në aktivitetin që synonte të nxiste dhe të mbështesë zhvillimin inteligjent e të qëndrueshëm të bashkive/qyteteve, ishin të pranishëm dy nga kryetarët më në zë të dy bashkive daneze, të cilët ndanë me homologët shqiptarë praktikat më të mira me anë të shembujve nga komunitetet e tyre.



DIFERENCAT JANË ATO QË NA BASHKOJNË

Në datat 11-13 Qershor, ShAV morri pjesë në Konferencën e Bashkive dhe Rajoneve mbi Barazinë, Përfshirjen dhe Diversitetin, të zhvilluar në Spanjë, ku Shqipëria u bë pjesë e diskutimeve mbi përfshirjen e gruas në politikë, sigurinë në hapësirat publike, rrjetet sociale, përfshirjen në tregun e punës dhe qeverinë e hapur lokale.



OBJEKTIVAT E SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE PËR VITIN 2018

ShAV do të vazhdojë veprimtarinë e saj duke patur në focus rritjen e bashkëpunimit me universitetet, median, partnerët nga shoqëria civile dhe grupet e interesit për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere me komunitetet lokale kryesisht në zonat rurale dhe të izoluar.

Rritje e transparencës dhe llogaridhënies në bashki, përmes lehtësimit të përfshirjes së komuniteteve në proceset demokratike e social-kulturore, si dhe Rritje e bashkëpunimit me specialistët ndërkombëtarë dhe donatorët e huaj me synim ofrimin e trajnimeve cilësore dhe të asistencës teknike për burimet njerëzore, dhe mënyrës së komunikimit me qytetarët në institucionet e qeverisjes vendore.



RRITJA E KAPACITETEVE

Zhvillimi i kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej përpjekjeve kryesore në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor. Prioriteti i SHAV është mbështetja e administratës lokale, për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe nevojave të komunitetit për shërbime publike të specializuara.



EDUKIMI DHE SPORTI

Edukimi dhe sporti janë dy komponent tejet të rëndësishëm për zhvillimin e një ekosistemi social-kulturor të qëndrueshëm për çdo komunitet në vend. SHAV ka si mision që përmes nxitjes së bashkëpunimit shkollë-komunitet-familje në proceset promovuese dhe zhvilluese të formimit personal të të rinjve në njësinë vendore të përfshijë ata vetë në vendimmarrjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre personale.



MJEDISI

Bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të njësisë vendore për mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit të lokalitetit është një domosdoshmëri për ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit ku këto komunitete punojnë dhe jetojnë.

“Forumi Lokal” është rubrika e cila do të trajtojë analiza, komente, intervista dhe opinione ardhur drejtpërdrejt nga drejtues dhe punonjës të njësive administrative nga i gjithë vendi. Kjo rubrikë synon të mbulojë një sërë tematikash me rëndësi për jetën dhe aktualitetin në komunitetet lokale në mbarë Shqipërinë. Në numrin e parë, përmes një interviste të shkurtër me katër personazhe nga bashki të ndryshme të vendit, vijnë për lexuesin katër tema që lidhen drejtpërdrejt me procesin e reformës territoriale dhe të decentralizimit.

1



ASPEKTE TË NDRYSHME TË ADMINISTRIMIT TË MJEDISIT LOKAL

Opinion nga Rajmonda Balilaj, Kryetare e Bashkisë Patos

Natyrë dhe Historia jonë frymëzojnë!

Askush tjetër nuk ka forcën ta kthejë këtë vend në histori suksesi, veç atyre që besojnë tek e ardhmja e mjedisit, turizmit dhe e vendit tonë!

Bashkia Patos në politikat lokale mjedisore, është angazhuar të ndër marrë nisma dhe të jetë në koherencë të plotë me politikat dhe strategjitë kombëtare të ruajtjes së mjedisit.

Kultivimi i kulturës së mjedisit është shtrirë në të gjithë komunitetin, duke angazhuar disa grupe lokale si: Ambasadorët e Natyrës, grupim vullnetar me nxënës të ciklit të ulët; Grupi EkoMjedisor, projekti më i ri i Bashkisë Patos për të angazhuar të rinjtë me aksione vullnetare mjedisore, sipas standarteve Europiane, mbështetur nga Këndi i BE-së.

Projektet me të cilat janë angazhuar të gjithë aktorët lokal: “Arti që kalon nga koshi”- Konkurs midis shkollave me ide kreative nga materiale të riciklueshme;

“Gjelbërimi i shkollës së Oficinës”- Shtim i hapësirave të gjelbra në mjediset shkollore, edukim mjedisor të nxënësit;

“Krijimi i lulishtes rekreative”- Kontrata Sociale me të rinjtë, një kërkesë e plotësuar për YAG Group, Grupin Rinor Këshillimor Patos;

“Nesër do të them Faleminderit”- Projekti për minimizimin e mbetjeve. Veshjet dhe objektet e vjetra dhurohen për njerëzit në nevojë;



“Diferencimi i mbetjeve në burim”- Projekt pilot në fshatin Frashër për ndarjen e mbetjeve në dy rryma, të riciklueshme dhe të pariciklueshme;

“Çtë sheh syri, ta bën dora”- Sfilata me veshje të riciklueshme me nxënës të Qendrës Kulturore të Fëmijëve;

“Duar të vogla ndryshojnë botën”- Mbjellja e luleve shumëngjyrëshe në shkollat e qytetit dhe krijimi i ambjentëve rekreative me material të riciklueshme;

“Mjedisi i gjelbër në shkollë”- Uji-Energjia-Mbetjet shfrytëzimi me limit të burimeve të tokës.

Çdo vit Bashkia Patos ndërmerr nisma lokale dhe bëhet pjesë e nismave kombëtare, duke sensibilizuar, ndërgjegjësuar dhe bërë pjesë aktive të aksioneve qytetarë në këto aktivitete. Në pararojë të çdo aksioni është administrata e Bashkisë Patos, si aktorët kryesorë të hartimit dhe zbatimit të politikave mjedisore.

Vetëm për vitin 2018, Bashkia Patos numëron rreth 8000 pemë më shumë fal nismës së “Mbill Pemën Tënde”, nismë që gjeti mbështetjen e bizneseve, shkollave, qytetarëve.



FORUMI LOKAL

2



**SYNIMI JONË NXITJA E FORMAVE TË
NDRYSHME TË TURIZMIN NË TË GJITHË
BASHKINË E KORÇËS**

Benila Terova,
Nënkryetare e Bashkisë Korçë

**KORÇA NJË PREJ QYTETEVE MË TË DASHUR E PLOTË
NGJYRA NË SHQIPËRI GJITHMONË E MË TEPËR PO
KTHEHET NË NJË QENDËR GRAVITETI JO VETËM PËR
TURIZMIN VENDAS POR EDHE ATË NDËRKOMBËTAR.
A MENDONI SE PUSHTETI LOKAL I DISPONON
TË GJITHA KOMPETENCAT DHE KAPACITETET E
DUHURA NJERËZORE PËR TË MENAXHUAR CILËSISHT
NEVOJAT GJITHMONË EDHE NË RITJE TË SEKTORIT
TURISTIK?**

Për Bashkinë e Korçës, turizmi mbetet një nga prioritetet tona zhvillimore, jo vetëm bazuar te resurset natyrore, trashëgimia e pasur kulturore dhe historike, por edhe te projektet tona të shumta në këtë drejtim.

Investime, festa dhe aktivitete të larmishme gjatë gjithë vitit për të tërhequr sa më shumë vizitorë në qytetin e Korçës dhe atraksionet turistike përreth saj, duke e parë këtë potencial si burim për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Me kapacitete të shtuara akomoduese dhe rritje të investimeve të brendshme, të orientuara në funksion të zhvillimit të turizmit, ky qytet po tenton që të tërheqë edhe më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, është përgjegjësi e ndarë e një numri të konsiderueshëm aktorësh, përfshi institucionet qendore dhe vendore, sipërmarrjet e turizmit, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët. Në Korçë ka një bashkëpunim shumë të mirë midis të gjithë këtyre aktorëve, të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në menaxhimin sa më cilësor të nevojave gjithmonë edhe në rritje të sektorit turistik.

Korça ka të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore për të menaxhuar cilësisht nevojat e sektorit turistik. Në strukturën e Bashkisë Korçës, ka një Drejtori për Hartimin dhe Implementimin e Projekteve dhe Turizmit, e cila është pjesë aktive e hartimit të strategjive për zhvillimin e turizmit në qytet. Kjo drejtori harton dhe implementon projektet, krijon dhe mban kontakte me aktorë të interesuar në fushën e turizmit dhe jo vetëm, si edhe lehtëson bashkëpunimin me aktorë për përmirësimin e produkteve turistike dhe marketingun e tyre.

Në qendër të qytetit ndodhet Zyra e Informacionit Turistik, e cila ofron informacion të nevojshëm për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj. Gjithashtu, operojnë 2 udhërrëfues të çertifikuar, të cilët ofrojnë guida turistike në qytetin e Korçës dhe zonat e tjera turistike përreth saj. Agjencitë turistike private që operojnë në Korçë, ofrojnë paketat e tyre që tërheqin akoma më tepër vizitorët vendas dhe të huaj. Pazarit i Vjetër në Korçë, është një ofertë e shkëlqyer turistike për vizitorët me profilin e tij të veçantë të vlerave të trashëgimisë që mbart dhe llojin



e aktiviteteve që Bashkia po nxit dhe mbështet të organizohen aty.

Reforma territoriale ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e turistik si edhe në orientimin më të mirë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Si rezultat i decentralizimit, në planet për zhvillimin e turizmit në Korçë, është përfshirë Dardha, Voskopoja si edhe njësitë administrative rreth saj, të cilat janë praktika reale të bashkisë tonë që tregojnë se reforma është tepër e rëndësishme. Atraksione tepër të frekuentuara sidomos gjatë fundjavës, janë Voskopoja, Dardha, Boboshtica, Vithkuqi, të cilat së bashku me aktivitete të festa e mëdha kombëtare e ndërkombëtare, janë pjesë e paketave turistike për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj. Synimi i Bashkisë Korçë është hartimi i politikave integruese për një turizëm të qëndrueshëm në të gjithë zonën, duke mbështetur dhe nxitur forma të ndryshme turizmi, tepër tërheqëse kryesisht për vizitorët e huaj, të cilat ofrohen tashmë, si turizmi malor dhe kulturor. Në këtë drejtim, synohet të hidhen hapa konkretë dhe të hartohen strategji të veçanta në bashkëpunim me pushtetin qendror, që do të orientohen nga nevoja për investime në këto zona, përmirësimi i infrastrukturës ndërlidhëse me zona të largëta, mbështetja e agroturizmit, ngritjes së tregut për fermerët, si dhe promovimi i produkteve tradicionale të zonës. Vlen të theksojmë se Bashkia e Korçës, është përfituese e investimeve të rëndësishme në sektorin e turizmit, nga projekti i Qeverisë, "100 Fshatra Turistike". Po ashtu përfituese e një pakete, me fokus infrastrukturën dhe trashëgiminë kulturore, të BE dhe BERZH.

HISTORI SUKSESI PROJEKTI WISE



• SHAV FITON PROJEKTIN E BE-SË PËR NOVACION DHE FORCIMIN E EVROPËS - WISE

“Novacioni dhe Forcimi i Evropës” - WISE është një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian i koordinuar nga Shoqata Evropiane për Demokracinë Lokale - ALDA dhe zbatuar nga 16 Organizata në mbarë kontinentin evropian. Në Shqipëri ky projekt ka nisur implementimin e tij përmes Shoqatës për Autonomi Vendore. WISE është një projekt që kryesisht fokusohet në nxitjen e angazhimit demokratik dhe qytetarisë aktive në hartimin e politikave lokale dhe sindikale. Reflektimi në të kaluarën është hapi i parë. Adresimi i nevojës për të kuptuar dhe indentifikuar shkaqet e problemeve aktuale dhe mjetet e aksesueshme, është qëllimi kryesor për arritur ndryshimet e dëshirueshme.

Pikërisht hapat e projektit do të fokusohen respektivisht mbi sfidat aktuale dhe mbi skenarin e mundshëm të ardhshëm të BE. Qytetarët do të angazhohen se si mund të shkojnë drejt një ndryshimi pozitiv.

Objektivat e këtij projekti kanë për qëllim:

- Të nxisin qytetarinë evropiane dhe të përmirësojnë pjesëmarrjen qytetare dhe demokratike në nivel evropian.
- Të rrisin ndërgjegjësimin ndaj përkujtimit të vlerave, historisë së përbashkët dhe promovimit të paqes.
- Të inkurajojnë pjesëmarrjen demokratike dhe qytetare në nivelin e Bashkimit Evropian, duke informuar qytetarët mbi proceset e bërjes së politikave të BE-së, përfshirjes shoqërore e ndërkulturore dhe vullnetarizmin në nivel evropian.

- Nxitjen e debateve mbi Euroscepticismin
- Luftën ndaj stigmatizimit të imigrantëve dhe nxitjen e dialogut ndërkulturore dhe mirëkuptimin reciprok.
- Nxitjen e debateve konstruktive mbi për të ardhmen e Evropës.

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë arritja e një marrëveshjeje për aktivitetet e planifikuara dhe zbatimin në tërësi të objektivave të tij. Kjo do të pasohet nga hartimi i një pakete monitorimi dhe komunikimi me qëllim promovimin e objektivave.

Shoqata për Autonomi Vendore në projektin WISE do të zhvillojë komponentin “Eu learn”, i cili ka të bëjë me edukimin e të rinjve në vend mbi insitucionet, rolin dhe integrimin në Bashkimin Evropian.

• PËRFSHIRJA RINORE NË KOMUNITET NDIHMON INTEGRIMIN

Në kuadër të këtij projekti, Shoqata për Autonomi Vendore ishte pranë të rinjve të Burrelit për të diskutuar me ta rreth integritimit dhe rolit të tyre në këtë proces.

SHAV zhvillojë një takim informues me gjimnazistë të talentuar të shkollës “Pjetër Budi” dhe “28 Nëntori” në Burrel. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të “Save the Children”, drejtuesja e Zyrës Arsimore Mat dhe përfaqësues të Zyrës së Informacionit të BE pranë Bashkisë së Matit të cilët diskutuan dhe informuan të rinjtë



rreth historikut, institucioneve dhe sfidave të Unionit si ajo e zgjerimit dhe multikulturalizmit. Projekti WISE përveç se mbështet dhe nxit informimin e komunitetit për rolin e rëndësishëm që ka integrimi në raport me zhvillimin e demokracisë lokale, ai synon që nëpërmjet komponentit "EU Learning" të përfshijë të rinjtë e vendeve të Evropës juglindore në procesin e integritimit. Në këtë takim SHAV u tha të rinjve se përfshirja e tyre aktive në proceset komunitare do të ndihmonte drejtpërdrejt në integrimin e vendit. Gjithashtu në këtë takim u vendos theksi tek rëndësia që arsimi ka në formëzimin e qytatarëve të rinj evropian.

“

MEGI DHE KLAJDI

Gjatë takimit të zhvilluar nga Shoqata për Autonominë Vendore në Bashkinë Burrel, në kudër të implementimit të projektit WISE mbi fushatën informuese të komunitetit rinor në rolin e rëndësishëm që ka edukimi dhe ata vetë në procesin integruar të vendit drejt Bashkimit Evropian, dy prej të rinjve të përfshirë në këtë projekt nëpërmjet një video mesazhi i përcollen bashkëmoshatarëve të tyre mesazhe ndërgjegjësuese. Megi dhe Klajdi, dy të rinjtë të angazhuar në jetën komunitare të bashkisë së Burrelit vlerësuan aktivitetin e informimit duke theksuar se më shumë se i vlefshëm ai u shërben të rinjve për informacionet më të fundit nga BE.

”



MEGI

Projekti WISE është mjaftueshëm i vlefshëm për të gjithë të rinjtë.

KLAJDI

Projekte të tilla njohin të rinjtë me informacion për më të rejtat nga BE.

ANËTARËT



Bashkia Belsh



Bashkia Berat



Bashkia Bulqizë



Bashkia Cërrik



Bashkia Delvine



Bashkia Divjakë



Bashkia Durrës



Bashkia Elbasan



Bashkia Fier



Bashkia Finiq



Bashkia Fushë Arrëz



Bashkia Gjirokastrë



Bashkia Gramsh



Bashkia Has



Bashkia Himarë



Bashkia Kavajë



Bashkia Këlcyrë



Bashkia Kolonjë



Bashkia Konispol



Bashkia Korçë



Bashkia Krujë



Bashkia Kuçovë



Bashkia Kurbin



Bashkia Libohovë



Bashkia Librazhd



Bashkia Lushnjë



Bashkia Malësi Madhe



Bashkia Maliq



Bashkia Memaliaj



Bashkia Mirditë



Bashkia Patos



Bashkia Peqin



Bashkia Peshkopi



Bashkia Polican



Bashkia Prrenjas



Bashkia Pukë



Bashkia Pustec



Bashkia Roskovec



Bashkia Rogozhinë



Bashkia Sarandë



Bashkia Shijak



Bashkia Skrapar



Bashkia Tepelenë



Bashkia Tiranë



Bashkia Ura Vajgurore



Bashkia Vlorë

PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statutë, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfitim e eksperiencave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale Europiane dhe JugLindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



UNITED NATIONS



UNDP



EU COMMISSION




EU DELEGATION



USAID



US EMBASSY IN TIRANA



SWISS COOPERATION



GIZ



HANS SEIDEL FOUNDATION



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG FOUNDATION



OPEN SOCIETY FOUNDATION



OSCE



GOVERNMENT OF ALBANIA



PARLIAMENT OF ALBANIA



NALAS



CCER



EUROPEAN ASSOCIATION OF LOCAL DEMOCRACY



EMILIA ROMAGNA ANCI



CNVP



AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION



FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE



KDZ



WORLD VISION



FEDERATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE



VNG INTERNATIONAL



DECENTRALIZATION AND LOCAL DEVELOPMENT PROGRAMME



THE WORLD BANK

Website i ri I pasuruar me përmbajtje substanciale dhe rubrika të reja novatore

Na vizitoni në www.shav.al



Të rejat më të fundit dhe nga celulari juaj?

Për t'u informuar në kohë reale

REGJISTROHU



**SHOQATA
PËR AUTOMINË
VENDORE**

